



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi

Datë: 12.02.2019

Numri i seancës për këtë çështje:

*Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).*

**A. Informacioni bazë**

Institucioni dhe tema:	<i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit</i>
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>Irma Balli</i>
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Drejtuuese e Prokurorisë së Apelit, Korçë</i>
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Nuk pati shtyrje të seancës. Filloi sipas njoftimit në orën 12.00 dhe vazhdoi deri në orën 14.00.</i>
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmblodhur)	<i>Dhënia e vendimit u shty për ne datën 14/02/2019 .</i>

**B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca**

Trupa gjyqese (emrat)	Lulzim Hamitaj (Kryetar); Olsi Komici (relator); Suela Zhegu (anëtare)
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Martin Kessen
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Mbrojtja u krye personalisht nga subjekti
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Dafina Zeneli</i>
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Seanca u monitorua nga një vëzhguese e Avokatit të Popullit, si dhe nga 5 anëtarë nga publiku.
Media e pranishme:	Ishin të pranishëm përfaqësues të medias; Birn, TV Scan, Ora News

C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendosi të kryejë procesin e vettingut, vetëm për kriterin e pasurisë, duke i përjashtuar dy kriteret e tjera, për figurën dhe aftësitë profesionale.	Kryetari i trupit gjykues, u shpreh se vendimi për të bërë vettingun, vetëm për një kriter, nuk është diskriminues, madje e cilësoi si një praktikë të konsoliduar.	Subjekti shprehu pakënaqësinë, sepse nuk ishte rivlerësuar për të tre kriteret. Qëllimi i ligjit është pastrimi i sistemit dhe duhet të hetohet në të tre komponentët, nëse jam korrekte apo e korruptuar për shkak të detyrës, theksoi subjekti. Gjithashtu Znj. Balli e cilësoi shokuese analizën e KPK-se por dhe tha se ishte e tronditur dhe nga raporti i ILDKPKI-së.
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	Lidhur me këtë kriter, relatori i çështjes Olsi Komici, paraqiti rezultatet e hetimit kryesisht nga ana e KPK-së, por paralelisht edhe vlerësimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.	ILDKPKI dhe KPK	Ne përfundim të paraqitjes së rezultateve të hetimit të thelluar të KPK-së, mbi pasurinë, ku u evidentuan: mungesa e burimeve të ligjshme, mos justifikim i investimeve, mospërputhje me investimin fillestar, si dhe shmangie e detyrimeve tatimore, gjetjet u kundërshtuan nga subjekti. Për rrjedhojë prokurores Balli iu kërkua nga trupi gjykues, të argumentojë pretendimet e saj dhe nëse mund të siguroje dokumente, për të provuar burimin e të ardhurave, mes të cilave edhe trashëgiminë dhe mbështetjen financiare, dhënë të atit të saj nga gjyshi që jetonte në SHBA. Pas shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues u shpreh, se provat e paraqitura, do të merren në analizë në vendimin përfundimtar.
	Pasuria familjare ne fund te vitit 2017, 42.9 milionë lekë, nga te cilat; Pasuri te paluajtshme 19.4 milionë leke, 11.2 milionë likuiditet bankar, kursime cash të akumuluar 9.7 milionë lekë. Të ardhurat sipas deklarimit burojnë kryesisht nga paga e subjektit (prokurore) dhe bashkëshortit të saj, si edhe nga biznesi (pika e karburantit) dhënë me qira.	Relatori Olsi Komici	
	Pasuritë e paluajtshme te deklaruarat: 1. Bashkëpronare me 25% e një trualli prej 170 m2 si dhe një ndërtesë 120 m2 në qytetin e Korçës (kati i parë i objektit, shfrytëzohet si pike karburanti dhe dyqan) 2. Apartament 179 m2 (nga bashkimi i dy apartamenteve të blera në vitin 2004, me vlere përkatësisht 2.1 milionë lekë dhe 2.5 milionë lekë. 3. Garazh me sipërfaqe 58 m2, blerë në vitin 2011 në vlerën e 1 milion lekëve. 4. Shtesë papafingo prej 24.9 m2, e legalizuar në pikën e karburantit, ne vitin 2015.	KPK	
	Te tjera: 1. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, zotëron 25% të aksioneve të kompanisë së shitjes së karburantit. Burimi i të ardhurave për ngritjen e pronës, deklarohet emigracioni i tij në Greqi. Rezulton e paprovuar me dokumentacion, sipas KPK-së. 2. Automjet tip Toyota, blerë në 2006, me vlerën 1.2 milionë lekë.	KPK	

	<p>Relatori u shpreh, se Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, ILDKPKI ka vlerësuar se Balli ka kryer deklarinim të rremë dhe të pasaktë si dhe nuk ka burime të ligjshme për pasurinë e saj. Edhe nga hetimet e thelluara të KPK-së, kanë rezultuar probleme: që nga mungesa e burimeve të ligjshme, mos justifikimi i investimeve, shmangia e detyrimeve tatimore.</p>	KPK dhe ILDKPKI	
	<p>Subjekti kundërshtoi konstatimet dhe rezultatet e hetimeve si të KPK-së ashtu edhe ILDKPKI-së. “Qëllimi i këtij ligji është pastrimi i sistemit dhe hetimit në të tre komponentët. Është element i rëndësishëm verifikimi shkak-pasojë. Jam korrekte ose e korruptuar për shkak të detyrës. Më është dukur shokuese analiza juaj. Jam trishtuar se nuk ishte objektive dhe janë shkelur të drejtat. Paskam qenë e paragjykuar!”, u shpreh prokurorja. Ajo theksoi gjithashtu se ka pasaktësi në konkluzionet rreth pasurisë së saj dhe familjarëve.</p>	Subjekti i rivlerësimit	
<p><b>D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar</b></p>	<p>Nuk u vlerësua ky kriter.</p>		
<p><b>D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës</b></p>	<p>Nuk u vlerësua ky kriter.</p>		
<p><b>E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)</b></p>	<p>Seanca për rivlerësimin e subjektit Irma Balli, Drejtuese e prokurorisë së Apelit Korçë, zgjati dy orë, kohë gjatë së cilës, relatori i çështjes paraqiti rezultatet e hetimit të thelluar nga KPK, lidhur me pasurinë e subjektit. Për afro gjysmë ore, edhe subjekti paraqiti pretendimet dhe konkluzionet e saj. Një nga kundërshtimet kryesore të subjektit, ishte mosrealizimi i procesit të vettingut për të tre kriteret, duke e vlerësuar rastin si të paragjykuar dhe në shkelje të parimit për një proces të rregullt ligjor. Ndonëse trupi gjykues e cilësoi si një praktikë të konsoliduar procesin e vettingut me një kriter (pasuria), kjo mënyrë procedimi, krijon një standard të dyfishtë gjykimi me subjektet e tjera të rivlerësimit. Kjo për faktin, se nuk ka kriteret të përcaktuara, të cilat do ta bënin të pakontestueshme, vendimmarrjen e trupit gjykues për mos vlerësimin në të tre komponentët. Pavarësisht kalimit ose jo të kriterit pasuror, është e drejtë e subjektit të njihet edhe me rezultatet e vlerësimit për dy kriteret e tjera, atë moral dhe profesional. Me këtë rast, ajo solli në vëmendje se ishte certifikuar nga DSIC për pesë vite për të pasur akses në dokumente tepër sekrete, që nuk ishte përfshirë në raport. Sa i përket rezultateve të hetimit të KPK-së, rezultoi se subjekti ishte vënë në dijeni më herët, duke iu vënë në dispozicion koha e arsyeshme, për të paraqitur prova të reja, si edhe për të përgatitur konkluzionet përfundimtare. Por kërkesa e saj, e paraqitur në seancë për të thirrur dëshmitarë, u refuzua nga trupi gjykues. Për afro gjysmë ore gjatë shpjegimeve të dhëna, prokurorja kundërshtoi raportin e ILDKPKI, për të cilin tha se ishte e tronditur, pasi edhe pse ka deklaruar pasurinë pranë këtij institucioni që nga viti 2003, asnjëherë nuk është thirrur apo të jetë adresuar ndonjë ankese ndaj saj për deklarinim të pasaktë. Edhe rezultati i hetimit të KPK-së, u kundërshtua nga subjekti, me pretendimin se ka disa pasaktësi financiare. Prokurorja theksoi se ka nisur punë me bashkëshortin që në vitin 1987 dhe nuk mund të nise nga zeroja analiza në vitin 2003, kur ka startuar deklarimi pranë ILDKPKI. Subjekti kërkoi ri konfirmimin në detyrë. Në lidhje me parimin e publicitetit të gjykimit, rezultoi se është respektuar. Data, vendi, dhe ora e zhvillimit të seancës dëgjimore u njoftuan paraprakisht, në faqen zyrtare të KPK-së. Seanca ishte e hapur për të interesuarit, që mund ta ndiqnin atë, ndërsa kamerave iu dha mundësia të xhironin vetëm gjatë hapjes së seancës.</p>		